

Vendim nr. 29 datë 01.11.2022

(V-29/22)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Vitore Tusha, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Elsa Toska, Altin Binaj, Sandër Beci, Ilir Toska, Sonila Bejtja, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 01.11.2022 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 5 (S) 2022 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **STILIANO HAJDARI, LIMONETA ÇOLLAKU (HAJDARI), ALEKS HAJDARI, LEONARD HAJDARI, ELIDON HAJDARI**

SUBJEKTE TË INTERESUARA

**MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS,
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR,
KËSHILLI I MINISTRAVE**

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 323, datë 23.02.2015 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2022-5, datë 17.01.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit dhe gjykimi brenda një afati 6-mujor me tjetër trup gjykues.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 11, 15, 17, 41, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sonila Bejtja, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuësve, të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Këshillit të Ministrave dhe Autoritetit Rrugor Shqiptar, të cilat kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi se Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës nuk ka paraqitur prapësime me shkrim, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuësit janë trashëgimtarë ligjorë të shtetasit Zenel Hajdari (subjekti i shpronësuar), i cili ka qenë pronar i një shtëpie banimi 3-katëshe, të ndodhur në rrugën “Selim Braja”, Sauk i Vjetër, Tiranë, pronësi e fituar në bazë të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

2. Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 08.06.2011 “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Unaza e Madhe e Tiranë” (VKM nr. 408/2011) është vendosur, mes të tjerash, edhe shpronësimi i banesës së subjektit të shpronësuar për interes publik, për efekt të ndërtimit të segmentit rrugor Unaza e Madhe e Tiranës. Në listën bashkëlidhur kësaj VKM-je, ky shtetas rezultoi me numër rendor 13, me vendndodhje ZK 3266, me vlerë pasurie të miratuar sipas preventivit 9.263.153 lekë për objektin shtëpi banimi + lokal, si dhe me shënimin se është në proces legalizimi.

3. Në datën 03.11.2011 subjekti i shpronësuar, me pretendimin se për VKM-në nr. 408/2011 ka marrë dijeni në mënyrë jo zyrtare (nëpërmjet medieve dhe gazetave), i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (MPPT), duke kërkuar shpërblimin e drejtë të vlerës së pronës sipas çmimeve të tregut. MPPT-ja, me shkresën nr. 557 prot., datë 01.12.2011, ia ka refuzuar këtë kërkesë. Në këto kushte, ai i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi me objekt ndryshimin e VKM-së nr. 408/2011, si dhe detyrimin e palëve të paditura, MPPT-së, Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARRSH) dhe Këshillit të Ministrave, të përcaktojnë në mënyrë të drejtë dhe ta dëmshpërblejnë atë në shumën 10.459.846 lekë, që është diferenca mes vlerës reale në treg të banesës dhe vlerës së përcaktuar në VKM-në e shpronësimit.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 10819, datë 31.10.2013, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë, anulimin e pjesshëm të VKM-së nr. 408/2011

lidhur me masën e shpërblimit, si dhe detyrimin e të paditurve të paguajnë diferencën mbi vlerën e caktuar në këtë vendim në masën 8.118.344 lekë. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim ARRSH-ja dhe Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës.

5. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 323, datë 23.02.2015, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 10819, datë 31.10.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pushimin e gjykimit të çështjes, për shkak të paraqitjes së kërkesëpadisë tej afateve ligjore. Kundër këtij vendimi subjekti i shpronësuar ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë. Për shkak se ky shtetas ka ndërruar jetë, në Gjykatën e Lartë është bërë zëvendësimi procedural i tij me kërkuessit në cilësinë e trashëgimtarëve ligjorë.

6. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, me vendimin nr. 00-2022-5, datë 17.01.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuessit, pasi nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*).

7. Në datën 13.05.2022 kërkuessit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore sipas objektit të kërkesës. Me vendimin e datës 15.06.2022, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Kjo e fundit në datën 05.07.2022 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

8. **Kërkuessit** kanë pretenduar, në mënyrë të përmbledhur, se procesi gjyqësor i kundërshtuar u ka cenuar:

- 8.1. *Të drejtën e pronës private, të lidhur me të drejtën e aksesit dhe të ankimit, si pasojë e një procesi administrativ dhe gjyqësor të parregullt e në kundërshtim me ligjin. Gjykata Administrative e Apelit e ka pushuar çështjen pa e zgjidhur në themel dhe pa u dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në kërkesëpadi.*
- 8.2. *Standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, pasi Gjykata Administrative e Apelit nuk ka mbajtur qëndrim në lidhje me shkeljet e kryera nga organet administrative dhe faktin se ato nuk kanë ndërmarrë asnjë hap konkret për njoftimin drejtpërdrejt për shpronësimin. Vendimi i saj është kontradiktor dhe nuk ka arsyetuar se nga cila datë e ka llogaritur marrjen e njoftimit për*

shpronësimin e subjektit të shpronësuar. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk u ka dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të ngritura në rekurs, edhe pse ato kishin të bënin me interpretimin dhe zbatimin e gabuar të ligjit material. Ai nuk ka arsyetuar në lidhje me të drejtën e kërkuësve për t'u njoftuar drejtpërdrejt për vlerën e shpronësimit. Vendimi i atij kolegji bie në kundërshtim me praktikën e Gjykatës së Lartë.

9. **Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave**, ka parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

- 9.1. Në lidhje me cenimin e së drejtës së pronës private, pretendimet e kërkuësve janë të pabazuara dhe nuk i përgjigjen procedurës së zhvilluar dhe mënyrës së zhvillimit të pronës. Gjithashtu, ndërhyrja është proporcionale dhe kërkuësve u është dhënë një shpërblim i drejtë për pronën e shpronësuar.
- 9.2. Për sa u takon pretendimeve për cenimin e së drejtës së aksesit dhe së drejtës së ankimit, ato janë të pabazuara, pasi kërkuësit nuk kanë arritur të evidentojnë natyrën e shkeljes dhe të drejtat që u janë cenuar nga gjykimi në Gjykatën e Lartë. Kjo e fundit është vënë në lëvizje me rekursin e paraqitur nga subjekti i shpronësuar dhe u ka dhënë përgjigje pretendimeve të parashtruara në të, duke i garantuar të drejtën e ankimit dhe të aksesit.
- 9.3. Pretendimi për cenimin e standardit të arsytimit është i pabazuar, pasi Gjykata Administrative e Apelit ka arsyetuar për shkakun e prishjes së vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe pushimin e çështjes. Gjithashtu, ajo ka arsyetuar se kur është bërë publike VKM-ja nr. 408/2011, si dhe momentin e lindjes së të drejtës së paditësit për paraqitjen e kërkesëpadisë. Në çdo rast, njoftimi me shpallje në Fletoren Zyrtare dhe njoftimi nëpërmjet afishimit ose shpalljes publike janë forma të njohura nga Kodi i Procedurave Administrative (KPA) për njoftimin dhe marrjen dijani.

10. **Subjekti i interesuar, ARSSH-ja**, ka prapësuar, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

- 10.1. Gjykata Administrative e Apelit ka bërë një vlerësim të drejtë në lidhje me parashkrimin e kërkesëpadisë. Gjatë gjykimit është provuar se padia është paraqitur në datën 09.12.2011 dhe se subjekti i shpronësuar kishte marrë dijani në datën 14.07.2011.
- 10.2. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me të drejtë, ka vlerësuar se shkaqet e ngritura në rekurs nuk ishin nga ato të parashikuara në nenin 58 të

ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*).

11. **Subjekti i interesuar, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës**, nuk ka paraqitur prapësime.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuësve

12. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2 të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

13. Gjykata vlerëson se kërkuësit legjitimohen *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, në cilësinë e trashëgimtarëve ligjorë të subjektit të shpronësuar dhe palë në gjykim në Gjykatën e Lartë, për rrjedhojë kanë interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

14. Për sa i përket *shterimit të mjeteve juridike efektive*, bazuar në parashikimet e nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, si dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata konstaton se objekt i këtij ankimi kushtetues individual është vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit, që ka vendosur pushimin e gjykimit dhe ai i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, i cili ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuësve. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkuësit nuk kanë mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tyre kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

15. Gjykata vlerëson se kërkuësit legjitimohen *ratione temporis*, pasi ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 13.05.2022, ndërsa vendimi gjyqësor më i fundit, që kundërshtohet prej tyre, është dhënë nga Gjykata e Lartë në datën 17.01.2022. Për pasojë, kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

16. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae* Gjykata vëren se, në thelb, kërkesit kanë pretenduar se gjykatat u kanë cenuar të drejtën e pronës private dhe atë për proces të rregullt, në aspektet e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor dhe së drejtës së aksesit, pasi Gjykata Administrative e Apelit e ka pushuar çështjen duke mos e zgjidhur në themel, kurse Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të parashtruara në rekurs. Për rrjedhojë, në zbatim të parimit *iura novit curia*, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se argumentet lidhen me procesin gjyqësor të kundërshtuar, çmon ta analizojë çështjen në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë. Në këtë këndvështrim, nisur nga thelbi i pretendimeve të kërkesve, ato do të analizohen në vijim në drejtim të standardit të arsytimit të lidhur me të drejtën e aksesit.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit

17. Kërkesit kanë pretenduar se u është cenuar e drejta e aksesit, pasi gjykata e apelit e ka pushuar çështjen duke mos e zgjidhur atë në themel, si dhe Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje kërkesës kryesore të tyre që lidhej me afatin për të ngritur padinë, për të cilën është pushuar çështja nga gjykata e apelit. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk u ka dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të ngritura në rekurs, edhe pse ato kishin të bënin me interpretimin dhe zbatimin e gabuar të ligjit material. Ai kolegji nuk ka arsyetuar në lidhje me të drejtën e kërkesve për t'u njoftuar drejtpërdrejt për vlerën e shpronësimit.

18. Sipas subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, Gjykata Administrative e Apelit ka arsyetuar se kur është bërë publike VKM-ja nr. 408/2011, si dhe për momentin e lindjes të së drejtës për paraqitjen e kërkesëpadisë. Në çdo rast, njoftimi me shpallje në Fletoren Zyrtare dhe njoftimi nëpërmjet afishimit ose shpalljes publike janë forma të njohura nga KPA-ja për njoftimin dhe marrjen dijani. Kurse Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje pretendimeve të parashtruara në rekurs, duke garantuar të drejtën e ankimit dhe të drejtën e aksesit.

19. Ndërsa sipas subjektit të interesuar, ARRSH-së, Gjykata Administrative e Apelit ka bërë një vlerësim të drejtë në lidhje me parashkrimin e kërkesëpadisë, pasi gjatë gjykimit është provuar se padia është paraqitur në datën 09.12.2011, ndërkohë që paditësi kishte marrë dijani në datën 14.07.2011. Në lidhje me procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, Kolegji Administrativ,

me të drejtë, ka vlerësuar se shkaqet e ngritura në rekurs nuk ishin nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012.

20. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 10, datë 04.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 3, datë 20.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Arsyetimi i kufizuar, i dhënë nga Gjykata e Lartë në formulimin e vendimit në dhomë këshillimi, është tregues i faktit se kërkuesi nuk ka ngritur një nga argumentet ligjore të përcaktuara në dispozitën përkatëse të legjislacionit të brendshëm, që është kusht për pranimin e kërkesës (*shih vendimet nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 9, datë 26.03.2018; nr.8, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, jurisprudenca kushtetuese ka trajtuar edhe qëndrimin që duhet të mbajë Gjykata e Lartë në rastet kur për zgjidhjen në themel të çështjes ka dy vendime diametralisht të kundërta nga gjykatat më të ulëta. Ky rast është vlerësuar nga Gjykata nën dritën e së drejtës së aksesit dhe asaj të ankimit në kuptimin substancial, si dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, kur cenohen të drejta kushtetuese (*shih vendimin nr.73, datë 16.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Për sa i përket së drejtës së aksesit, Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimet nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, e drejta për të pasur akses në gjykatë i garanton individit të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë

një përgjigje përfundimtare prej saj, të arsyetuar, për pretendimet e ngritura (*shih vendimet nr. 11, datë 21.04.2022; nr.17, datë 24.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Gjykata vëren se, në thelb, pretendimet e kërkuesve për cenimin e standardit të arsytimit dhe të së drejtës së aksesit kanë të bëjnë me zbatimin e dispozitave të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar (*ligji nr. 8561/1999*), në lidhje me mënyrën e njoftimit të aktit të pushtetit publik për shpronësim dhe të drejtën e ankimit për këtë akt.

24. Sipas Gjykatës, interpretimi i ligjit është atribut i organeve që e zbatojnë atë dhe, nisur nga ky parim, sqarimi i kuptimit ose interpretimi i çdo dispozite ligjore të zbatueshme gjatë shqyrtimit të një çështjeje të caktuar është në kompetencë të gjykatave të sistemit të zakonshëm gjyqësor (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 1, datë 20.01.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar se kur gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përmes interpretimit dhe zbatimit të ligjit në një çështje konkrete cenojnë parimet, standardet ose të drejtat kushtetuese, atëherë interpretimi i ligjit i nënshtrohet kontrollit kushtetues. Në këto raste, Gjykata bën një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Pra, në këtë drejtim, bazuar në parimin e subsidiaritetit, interpretimi i ligjit material ose procedural është, së pari, detyrë e Gjykatës së Lartë, në mënyrë që më pas kontrolli kushtetues të rezultojë efektiv edhe për rastet kur ky interpretim cenon standardet ose parimet kushtetuese (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 62, datë 23.09.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Referuar akteve të dosjes gjyqësore, të administruara për nevoja të këtij gjykimi kushtetues, Gjykata vëren se subjekti i shpronësuar, pasi ka marrë dijeni për VKM-në nr. 408/2011 nëpërmjet gazetave dhe medieve, në datën 03.11.2011 i është drejtuar MPPT-së me kërkesë me objekt vlerësimin e drejtë të dëmshpërblimit për pronën e shpronësuar për interes publik. Në përgjigje të kësaj kërkesë, me shkresën nr. 557 prot., datë 01.12.2011, MPPT-ja i ka kthyer përgjigje duke e sqaruar: “*Lidhur me vlerësimin e objektit ju jeni vënë në dijeni në muajt prill-maj, periudhë në të cilën është bërë publikimi i kërkesës për shpronësim, pasi në bazë të këtij publikimi ju keni bërë kërkesë (me nr. 3050 prot., datë 03.05.2011), pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve, si për vlerësimin e objektit ashtu edhe për tokën. Njoftimi nuk ju është bërë personalisht, pasi MPPT nuk dispononte adresën tuaj [...]*”. Pas këtij komunikimi subjekti i shpronësuar ka filluar procedurat gjyqësore, duke kërkuar shpërblimin e drejtë për pronën e tij.

26. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 10819, datë 31.10.2013, ka pranuar kërkesëpadinë, duke arsyetuar: “[...] *vetë neni 24 i ligjit nr. 8561/999, parashikon*

detyrimin e ministrisë kompetente për njoftimin e drejtpërdrejtë të vendimit pronarëve të shpronësuar [...]. Në rastin konkret, paditësit, provohet se i është nisur shkresa nr. 557 prot., datë 01.12.2011, nga MPPT, ndërsa padia është paraqitur në gjykatë në datën 09.12.2011 [...]" (shih faqen 13 të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë).

27. Në ndryshim nga sa më sipër, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe pushimin e gjykimit të çështjes, duke arsyetuar: *“Sikurse parashtrohet edhe nga i padituri MTI, njoftimi për shpronësim nuk i është bërë personalisht, për shkak të mosdisponimit të adresës së paditësit, por se është kryer afishimi i kërkesës për shpronësim pranë njësive të qeverisjes vendore, si edhe është bërë publikimi në dy gazeta, sikurse parashikohet në nenin 15 të ligjit nr. 8561/1999 [...] ndaj rrjedhimisht paditësi, në rast se i cenohej ndonjë interes i ligjshëm, duhej ta kundërshtonte këtë akt brenda 30 ditëve nga marrja dijeni, çka nuk ka rezultuar realisht” (shih faqen 17 të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, paragrafin e fundit).*

28. Duke iu referuar rastit konkret, si dhe duke pasur parasysh faktin se shpronësimi e zhvesh individin nga e drejta e tij e pronësisë, Gjykata çmon të theksojë se institucionet shtetërore të përfshira në procesin e shpronësimit duhet të tregojnë kujdes të shtuar dhe duhet të interpretojnë e zbatojnë dispozitat ligjore në atë mënyrë që t'i garantojnë individit garancitë kushtetuese të parashikuara në nenet 41 dhe 42 të Kushtetutës. Në rastin konkret, Gjykata vëren se autoritetet përkatëse janë shprehur se për shkak të mosdisponimit të adresës së subjektit të shpronësuar, nuk i është bërë njoftimi personalisht atij, ndërkohë që, po të njëjtat autoritete kanë arritur të bëjnë identifikimin e adresës së tij kur kanë proceduar me shembjen e objektit të shpronësuar. Në këtë kuptim, Gjykata çmon se në këtë rast procesi i ndjekur prej këtyre autoriteteve nuk është trajtuar me kujdesin dhe seriozitetin e duhur.

29. Gjithashtu, Gjykata vëren se në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë, subjekti i shpronësuar ka ngritur pretendime për interpretimin e ligjit nr. 8561/1999, për mënyrën e njoftimit të aktit të pushtetit publik për shpronësim. Ky pretendim ka natyrë kushtetuese, pasi lidhet me fillimin e afatit të së drejtës kushtetuese të ankimit në gjykatë ndaj këtij akti për shpërblimin e drejtë, sipas nenit 41, pika 5, të Kushtetutës. Në vendimin e tij Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, edhe pse i ka pasqyruar këto pretendime, nuk u ka dhënë përgjigje përfundimtare, por ka vlerësuar se *“gjykatat e faktit i kanë dhënë përgjigje të argumentuar pretendimeve të palës rekursuese, për sa i përket shkeljeve ligjore, natyrës së tyre dhe çështjeve të faktit të lidhura me to (shih faqen 7 të vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë)”*.

30. Në kuptim të sa më sipër, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, tashmë Gjykata ka qëndrim të konsoliduar se, në zbatim të parimit të *subsidiaritetit*, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion për më tepër i Gjykatës së Lartë (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 6, datë 16.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Me ndryshimet e reja kushtetuese, neni 141 i Kushtetutës i ka dhënë Gjykatës së Lartë kompetencën e shqyrtimit të çështjeve lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore sipas ligjit (*shih vendimin nr. 17, datë 30.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Respektimi rigoroz i ligjit përbën detyrim për Gjykatën e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, për sa kohë ajo ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta (*shih vendimin nr. 16, datë 16.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Gjykata rithekson edhe një herë qëndrimin e mbajtur prej saj se është detyrë e Gjykatës së Lartë që, si gjykatë ligji, të arsyetojë, qoftë edhe minimalisht, në rastet kur pretendimet e ngritura në rekurs kanë të bëjnë me interpretimin e ligjit, veçanërisht kur interpretimi i ligjit lidhet me të drejta kushtetuese substanciale të individit (*shih vendimin nr. 19, datë 07.07.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Për më tepër, në rastin konkret, thelbi i procesit të zhvilluar në Gjykatën Administrative të Apelit ka qenë e drejta kushtetuese për shpërblimin e drejtë të pronës së shpronësuar.

32. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykata Administrative e Apelit kanë interpretuar dhe zbatuar në mënyra diametralisht të kundërta dispozitat ligjore të nenit 24 të ligjit nr. 8561/1999. Sipas kësaj dispozite: *“Vendimi i Këshillit të Ministrave për shpronësimin u njoftohet nga ministria kompetente drejtpërdrejt pronarëve të shpronësuar [...], të cilët vetëm lidhur me masën e shpërblimit të caktuar në këtë vendim kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 30 ditëve nga marrja dijani.”*. Në referim të kësaj dispozite, gjykata e shkallës së parë ka vendosur duke e zbatuar atë (*shih paragrafin 26 të këtij vendimi*). Nga ana tjetër, Gjykata Administrative e Apelit e ka interpretuar në mënyrë të ndryshme, duke konsideruar se e drejta e ankimit lidhet me marrjen dijani të aktit të shpronësimit, pavarësisht mënyrës se si subjekti i shpronësuar vihet në dijani, duke e bazuar vendimmarrjen e saj në nenin 15 të ligjit nr. 8561/1999.

33. Gjykata konstaton se kërkuesi në rekurs ka ngritur pretendime me natyrë kushtetuese lidhur me gjykimin në Gjykatën Administrative të Apelit dhe mënyrën e interpretimit të ligjit nr. 8561/1999 prej saj. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i ka konsideruar këto pretendime të subjektit të shpronësuar si çështje të vlerësimit të provave, edhe pse ato, në thelb, kanë të bëjnë

me interpretimin e ligjit që parashikon mënyrën e njoftimit të individëve për aktin e pushtetit publik për shpronësim (njoftim individual ose nëpërmjet publikimit), prej të cilit varet edhe momenti i fillimit të afatit të ankimit në gjykatë.

34. Për sa më sipër, Gjykata çmon se Gjykata e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, duhej të mbante një qëndrim në lidhje me këtë interpretim të bërë nga gjykatat më të ulëta dhe të ushtronte funksionin e saj subsidiar, duke i dhënë përgjigje të arsyetuar subjektit të shpronësuar për pretendimin e tij. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se arsyetimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë është i pamjaftueshëm dhe nuk përmbush kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për respektimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Gjithashtu, duke pasur parasysh edhe faktin se Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pushimin e gjykimit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke vendosur mospranimin e rekursit, ka sjellë si pasojë edhe cenimin e së drejtës së aksesit të kërkuesve.

35. Për sa i përket pretendimit tjetër të kërkuesve për cenimin e së drejtës së pronës, Gjykata vlerëson të mos ndalet në analizimin e tij, për sa kohë çështja do të merret përsëri në shqyrtim nga Gjykata e Lartë.

36. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesve janë të bazuara dhe duhet të pranohen sipas arsyetimit të mësipërm.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-5, datë 17.01.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
3. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë.
4. Rrëzimin e kërkesës për pretendimet e tjera.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 01.11.2022

Shpallur më 01.12.2022